

37
14.02.2017

Tirane, me 14/02/2017

KERKESE

Drejtuar: Agjencisë Kombetare të Mjedisit, Tiranë
Ministria e Mjedisit

Nga: A.I.B.A. KOMPANI Sh.A

Lenda: Konsultimet me Publikun per Aplikim për VNM te thelluar për aktivitetet
“Prodhim dhe tregtim të vezëve”, “Prodhimin, mbareshtimin dhe tregtimin te
zogjve” .

“A.I.B.A. KOMPANI” Sh.a është rregjistruar prane QKR-se (sot QKB) date 01/03/1993 me NIPT J61818528J, me zyra qendrore në adresën L.14, Rr. Tirana, Shkozet, Durres. Kompania ka aktivitet të diversifikuar në fushat e prodhimit, tregtimit, sherbimeve dhe transportit. Ndër aktivitetet në fushën e prodhimit jane: **“Prodhimin dhe tregtimin e ushqimeve blegtorale, “Prodhim dhe tregtim të vezëve”, “Prodhimin, mbareshtimin dhe tregtimin e zogjve” .**

Per ushtrimin e ketyre aktiviteteve kompania ka qenë e paisur më parë nga Ministria e Mjedisit me lejet perkatese mjedisore, si dhe ka kryer monitorimet ne permbushje te kerkesave te lejeve.

*Meqenese kompania AIBA nuk kreu procedurat brenda afateve te parashikuara ligjore per ta perputhur lejen ekzistuese sipas kerkesave te legjislacionit te ri ne fuqi, (Ligjit 10 431 ‘Për Mbrojtjen e Mjedisit’ datë 9.6.2011, Ligji 10 440, datë 07.07.2014, “Për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 13, datë 04.01.2014 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”), aplikon serish per t’u paisur me VNM tethelluar per aktivitetet **“Prodhim dhe tregtim të vezëve”, “Prodhimin, mbareshtimin dhe tregtimin te zogjve” .***

Persa me siper, në mbeshtetje të legjislacionit ne fuqi “Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis”, AIBA Kompani sh.a, parashtron pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, kërkesën për procedurat e konsultimit me publikun.

Bashkalidhur kerkeses gjeni draft VNM-te e thelluara per aktivitetet **“Prodhim dhe tregtim të vezëve”, “Prodhimin, mbareshtimin dhe tregtimin te zogjve” .**

Me respekt

Aelita Mani

Person I Autorizuar

Dr. Aelita MANI
Konsulente

